



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 214/11 Prot.

Pogradec, më 30.01.2023

VENDIM

NR. 10, DATË 26.01.2023

“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROCEDURAVE PËR SHPRONËSIM TË PASURIVE, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT PËR INTERES PUBLIK, ME OBJEKT “SHËTITORJA DRILON – TUSHEMISHT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.2 shkronja b, neni 23 pika 14, neni 54, neni 55, të ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik” të ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Pogradec për objektin “Ndërhyrje të transformimit urban – Shëtitorja Tushemisht dhe përmirësimi i segmentit rrugor Tushemisht – Dogana – Shën Naum”, pas relacionit të paraqitur nga drejtorja e P.K.ZH.T, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim procedurat për shpronësim të pasurive, pronë private që preken nga realizimi i projektit për interes publik, për objektin “Shëtitorja Drilon - Tushemisht”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e procedurave për shpronësim ngarkohet Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe komisioni i shpronësimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT
Sotiraq MANÇËRI

